NOTERI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER NIKOLETA P. GJORDENI
ADRESA MYSLYM SHYRI, NR.30
TEL: 696051791

# KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

**Nr. repertori: 2400** **Nr. koleksioni: 907**

**Tirane më 11/07/2024**




Ligjet referuese:

1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar

3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

A2024053100098456355

* Akti noterial përbëhet nga 7 fletë

A2024053100098456355

## KONTRATË SHITBLERJE KUOTASH

Në Tiranë, sot më datë 11.07.2024 **( dy mije e njezete e kater),** përpara meje noteres publike **NIKOLETA P. GJORDENI**, anëtar i Deges Vendore te Noterëve Tiranë, me seli ne Rruga "Myslym Shyri', pall 30, kati i dyte, u paraqitën palët e mëposhtme kontraktuese të cilat lidhin këtë kontratë si më poshtë vijon:

- **Z.GAZMEND METOHU**, atësia Ymer, amësia Gjinovefa, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Blv. Bajram Curri; Nd. 112; H. 10; Ap. 31; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 07/03/1963, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036365946 dhe nr. personal G30307140S, ne cilesine e ortakut te vetem te **Shoqerise "Mag Utilities" shpk**, person juridik shqiptar, regjistruar ne QKB, me date 30/12/2015, me **NUIS L52430023N,** me seli ne "Blloku Rezidencial 'Kodra e Diellit', A 0/1, Tirane, **zoterues i 1 kuote, dhe pjeses se zoteruar prej saj, me vlere te pergjithshme 100.000,00 leke (njeqind mije LEKE ), qe perben 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise,** në vijim referuar si "**Shitësi**";

*dhe*

- **Z. Resmi Nika**, atësia Nebi, amësia Ajshe, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Shkembit 03880075, Nd. 6, H. 1, Bërzhitë, Ibë, 1037, Tiranë, lindur më 22/10/1982 gjendja civile madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034491782 dhe nr. personal I21022021G, në vijim referuar si "**Blerësi**";

të cilat kanë rënë dakord të lidhin këtë Kontratë për Shitblerjen e Kuotave (në vijim referuar si "**Kontrata**") të shoqërisë "Margus" Shpk.

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noterja konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues i tij, si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noterja redaktimin e Kontratës së Shitjes të kuotave të kapitalit të Shoqërisë "MAG UTILITIES" Sh.p.k., sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme: Shitësit dhe Blerësit do t'iu bëhet referim veçmas si "**Pala**" dhe së bashku si "**Palët**".

## MEQENËSE

A. **Shoqëria "Mag Utilities" Shpk,** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NUIS L64828201C, me seli në adresën "Kruje, Bubq, Rruga e Ishmit, Km 1, Nr. 387", që zhvillon aktivitet tregtar në sektorin e prodhimit, ndërtimit, industrisë, tregtisë etj. (në vijim referuar si "**Shoqëria**").

B. Shoqëria ka një kapital me vlerë 100.000 (njeqind mijë) LEK, të përbërë nga 1 (një) kuotë më vlerë nominale 100.000 (njeqind mijë) LEK.

C. Shitësi është ortaku i vetëm i Shoqërisë, dhe zotëron të gjitha kuotat e Shoqërisë (siç vërtetohet nga ekstrakti bashkëngjitur i lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit).

D. Shitësi dëshiron të shesë të gjitha kuotat e Shoqërisë të barasvlefshme me 100% të kapitalit të saj (në vijim referuar si "**Kuotat**") dhe Blerësi dëshiron të blejë Kuotat dhe të drejtat që lidhen me to, në përputhje me kushtet dhe afatet e kësaj Kontrate.

A2024053100098456355

E. Palët kanë vendosur të lidhin këtë Kontratë me qëllim përcaktimin e kushteve dhe afateve për të drejtat dhe detyrimet reciproke në lidhje me shitjen dhe blerjen e Kuotave dhe transferimin e tyre nga Shitësi tek Blerësi.

***Për sa më sipër, Palët bien dakord si më poshtë vijon:***

**1. Parashtrimet**

1.1 Parashtrimet dhe shtojcat janë pjesë përbërëse dhe thelbësore e kësaj Kontrate.

**2. Objekti i Kontratës**

2.1 Sipas afateve dhe kushteve të përcaktuara në këtë Kontratë, Shitësi i shet dhe i kalon Blerësit Kuotat, dhe Blerësi pranon të blejë Kuotat, duke paguar Çmimin e Shitjes.

**3. Kalimi i titullit të pronësisë mbi Kuotat**

3.1 Palët bien dakord se kalimi i titullit të pronësisë mbi Kuotat nga Shitësi tek Blerësi do të ndodhë menjëherë me nënshkrimin e kësaj Kontrate.

3.2 Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Blerësi do të bëhet ortak i vetëm i Shoqërisë dhe do të zotërojë 100 % të kapitalit të saj.

3.3 **Shitesi Gazmend Metohu**, ortak i vetem i shoqerise **"MAG UTILITIES" shpk**, deklaron nen pergjegjesine e tij personale se heq dore nga te gjitha te drejtat qe i takojne mbi 1 (nje) kuote te zoteruar qe perben 100 % te kapitalit ne shoqerine **"MAG UTILITIES" shpk**, dhe te gjithe te drejtat dhe detyrimet mbi kete kuote i kalojne bleresit te ri me nenshkrimin e kesaj kontrate, pagesen e cmimit te shitrjes se kuotes dhe pas depozitimit te saj ne QKB .

***4.* Çmimi i shitjes**

4.1 Palët bien dakord se çmimi total fiks që Blerësi i paguan Shitësit për blerjen e Kuotës është i barabartë me vlerën nominale të saj, e barabartë me **500.000 (peseqind mijë) LEKE** (në vijim referuar si "**Çmimi i Shitjes**").

4.2 Palët deklarojnë dhe pranojnë se Blerësi i ka paguar Shitësit Çmimin e Shitjes në momentin e nënshkrimit të kësaj Kontrate.

4.3 Shitesi dhe Bleresi deklarojne se nuk kane asnje pretendim aktual dhe/ose te ardhshem ndaj njeri tjetrit ne lidhje me percaktimin e cmimit te shitjes se kuotes edhe nese ne te ardhmen do te rezultoje ndonje ndryshim financiar apo i cfaredo lloj natyre tjeter qe e ka origjinen perpara dates apo ne daten e nenshkrimit te kesaj kontrate ne shoqeri

**5. Deklarimet dhe Garancitë e Shitësit**

Shitësi i deklaron dhe i garanton Blerësit se:

**5.1 Pronari i ligjshëm**

Shitësi është pronari i ligjshëm dhe me të drejta të plota mbi Kuotat, sipas ligjit shqiptar, dhe ka fituar në mënyrë të ligjshme titullin e pronësisë mbi Kuotat.

**5.2 <u>Garancite</u>**

Shitesi posedon kuoten te lire nga cdo barre siguruese, peng, hipoteke, garanci pagese, barre mbi interesat, kufizim, opsion, pretendim, prokure apo angazhime te tjera te cdo lloj natyre.

Nenshkrimi i kesaj kontrate nga shitesi dhe plotesimi i kushteve te saj nuk perbejne shkelje apo jane ne kundershtim me normat e (i) statutit te shoqerise, (ii) ndonje gjykim apo urdher,vendim gjyqsor, dekreti apo vendimi te cdo autoriteti vendas apo te huaj subjekt i te cilit eshte shitesi, (iii) ndonje

A2024053100098456355

marreveshje, licence apo angazhim ne te cilin keta shites apo shoqeria eshte pale, qe do te cenonte aftesine e tij per te nenshkruar kete kontrate apo per te permbushur detyrimet qe rrjedhin prej saj, (iv) me ligjin e zbatueshem

**5.3 Gjendja pasurore dhe financiare e Shoqërisë**

Shoqëria është në gjendje të mirë pasurore dhe financiare nga data e themelimit të saj deri në datën e kësaj Kontrate dhe pasqyrat financiare dhe bilancet ushtrimore janë hartuar dhe depozituar pranë autoriteteve kompetente në përputhje me ligjin, te vena ne dipsozicion te bleresit dhe te njohura dhe te pranuara prej tij.

Shoqëria ka kryer dhe depozituar rregullisht të gjitha deklaratat e kërkuara nga ligji në lidhje me taksat, tatimet, detyrimet doganore, kontributet e sigurimeve shoqërore dhe këto deklarime dhe depozitime janë të vërteta dhe të sakta.

Bleresi deklaron se paraprakisht ka verifikuar gjendjen financiare te shoqerise dhe ka dijeni te plote ne lidhje me detyrimet dhe gjendjen e saj financiare dhe deklaron se njeh dhe pranon te blej kuotat e mesiperme me te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe shoqeria ka ne perpjestim me perqindjen e kuotave, duke mos pasur asnje pretendim nga shitesit per periudhen qe ka qene ortak tani dhe ne te ardhmen.

**5.4 Mosmarrëveshjet**

Shoqëria nuk është palë e paditur në gjykime administrative, civile, penale apo arbitrazh, dhe nuk ka nisur çështje civile, administrative, penale apo arbitrazh ndaj të tretëve. Kalimi nuk rrezikohet apo cënohet nga asnjë çështje administrative, civile, arbitrazh, penale apo hetime nga autoritete publike.

**5.5 Aktiviteti tregtar**

Nga data e themelimit, Shoqëria ka kryer aktivitetin e saj tregtar në përputhje me ligjin e zbatueshëm.

**5.6 Konflikti i interesit**

Shoqëria dhe ortakët e saj nuk kanë arritur apo lidhur marrëveshje, kontrata, transaksione që janë në konflikt interesi personal me interesin më të mirë të Shoqërisë ose me persona të lidhur me ortakët/administratorët e Shoqërisë, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

**6. Përgjegjësia e Shitësit**

6.1 Pa cënuar apo kufizuar të drejtat dhe mbrojtjen e parashikuar nga ligji, Shitësi do të dëmshpërblejë dhe do ta ruajë Blerësin nga çdo dëm, humbje (përfshirë por pa u kufizuar në pakësimin e vlerës së Kuotave), shpenzime e kosto që ka përballuar Blerësi për shkak të shkeljes dhe mosrespektimit të deklarimeve dhe detyrimeve të Shitësit sipas kësaj Kontrate, si edhe ndaj çdo detyrimi dhe/ose të drejte të të tretëve për shkak të mospërmbushjes së Shitësit apo të Shoqërisë që ka të bëjë me periudhën përpara datës së kësaj Kontrate.

6.2 Palët bien dakord se Shitësi do të ketë përgjegjësi ekskluzive ndaj Blerësit, duke e dëmshpërblyer këtë të fundit ndaj çdo dëmi, humbje, kostoje apo shpenzimi që ka pësuar Blerësi apo Shoqëria, përfshirë por pa u kufizuar në penalitete, sanksione, kërkesë për dëmshpërblim, pretendime të autoriteteve publike, personave fizikë për shkak të mospërmbushjes së Shitësit ose të Shoqërisë që kanë të bëjnë me periudhën përpara datës së kësaj Kontrate.

6.3 Shitësi merr përsipër të dëmshpërblejë dhe t'i rimbursojë Shoqërisë dhe Blerësit të gjitha detyrimet tatimore dhe tatimet e zbatueshme ndaj Kalimit.

**7. Zgjidhja e Kontratës**

7.1 Kjo Kontratë mund të zgjidhet me pëlqimin e përbashkët me shkrim të Palëve.

A202405310009845635

7.3 Kjo Kontratë mund të zgjidhet nga Blerësi, kundrejt njoftimit paraprak me shkrim prej të paktën 30 (tridhjetë) ditëve të dërguar në adresën e Shitësit, në rast:

a.shkelje, mosrespektim dhe mospërmbushje nga Shitësi të detyrimeve të tij sipas kësaj Kontrate që i shkaktojnë një dëm, detyrim apo shpenzim Shoqërisë ose Blerësit, përfshirë mospërmbushje të Shitësit ose të Shoqërisë që kanë të bëjnë me periudhën përpara datës së kësaj Kontrate. Në këtë rast, Kuotat do t'i transferohen Shitësit dhe ky i fundit do të jetë i detyruar t'i paguajë Blerësit një kusht penal të barabartë me ________ Euro, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditësh nga komunikimi me shkrim i Blerësit mbi zgjidhjen e kësaj Kontrate, si edhe do të kthejë Blerësit Çmimin e Shitjes që i është paguar Shitësit dhe shumat, financimet dhe kontributet e derdhura nga Blerësi tek Shitësi dhe/ose tek Shoqëria.

7.4 E drejta e secilës Palë për të zgjidhur këtë Kontratë nuk cënon, shuan apo ndryshon të drejtat e Palëve për dëmshpërblimin e plotë të dëmeve, shpenzimeve dhe kostove të përballuara, në kuptim të kësaj Kontrate.

7.5 Në çdo rast, zgjidhja e kësaj Kontrate do të sjellë transferimin e Kuotave tek Shitësi dhe kthimin Blerësit të Çmimit të Shitjes dhe të çdo shume, kontributi e financimi të derdhur nga Blerësi Shoqërisë apo Shitësit, brenda një afati maksimal prej 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e zgjidhjes së Kontratës, përveç pagesave të kushteve penale të parashikuara në këtë Kontratë.

## 8. Forca Madhore

Nëse njëra nga Palët nuk është në gjendje të përmbushë, plotësisht apo pjesërisht, detyrimet e saj sipas Kontratës për shkak të ndodhjes së një ngjarje të Forcës Madhore, kjo Palë, për të gjithë kohëzgjatjen e ngjarjes së Forcës Madhore, nuk do të jetë përgjegjëse për mospërmbushjen e saj dhe për pasojat e pashmangshme të shkaktuara nga ngjarja e Forcës Madhore. Në çdo rast, Palët do të bëjnë të gjitha përpjekjet për të minimizuar pasojat e ngjarjes së Forcës Madhore si edhe të informojnë me shkrim, brenda 14 (katërmbëdhjetë) ditësh pune Palën tjetër për ndodhjen e Ngjarjes së Forcës Madhore. Nëse Ngjarja e Forcës Madhore zgjat më shumë se 90 (nëntëdhjetë) Ditë Pune, Palët kanë të drejtë të zgjidhin këtë Kontratë kundrejt njoftimit paraprak me shkrim prej të paktën 30 (tridhjetë) ditësh dërguar Palës tjetër.

## 9. Ligji i zbatueshëm dhe gjykata kompetente

9.1 Kjo Kontratë rregullohet nga ligji shqiptar. Të gjithë mosmarrëveshjet apo pretendimet e Palëve në lidhje me këtë Kontratë, përfshirë për pa u kufizuar në mosmarrëveshjet lidhur me ekzistencën, fuqinë juridike, interpretimin dhe/ose zgjidhjen e kësaj Kontrate do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

## 10. Njoftimet

10.1 Të gjitha komunikimet që duhet të dërgohen në kuptim të kësaj Kontrate duhet të dorëzohen me letër porosi me kthim përgjigje, email me shtojcë të pandryshueshme, korrier ose mjet tjetër të përshtatshëm që vërteton marrjen e komunikimit, në adresat e selive të Palëve që rezultojnë në Regjistrin Tregtar Shqiptar.

10.2 Palët mund të ndryshojnë herë pas here adresat e mësipërme, kundrejt njoftimit paraprak me shkrim prej të paktën 5 (pesë) ditë dërguar Palës tjetër.

## 11. Shpenzimet

11.1 Secila nga Palët do të përballojë shpenzimet përkatëse për negocimin, përgatitjen dhe ekzekutimin e kësaj Kontrate.

## 12. Marrëveshja e Plotë

12.1 Kjo Kontratë përbën marrëveshjen e plotë ndërmjet Palëve në lidhje me objektin e saj dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet, komunikimet dhe deklarimet e mëparshme ndërmjet Palëve, si me shkrim ashtu edhe me gojë.

A2024053100098456355

**13. Ndryshimet dhe shtesat e Kontratës**

13.1 Ndryshimet dhe shtesat e mundshme të kësaj Kontrate (përfshirë Shtojcat) do të jenë të vlefshme vetëm nëse bëhen me shkrim dhe nënshkruhen nga Palët.

**14. Pavlefshmëria e neneve të veçanta të Kontratës**

14.1 Pavlefshmëria e cilitdo nen të kësaj Kontrate nuk do të cënojë vlefshmërinë e parashikimeve të tjera të saj. Nëse do të rezultojë që një apo më shumë parashikime të kësaj Kontrate janë të pavlefshme, Palët do të angazhohen të ndryshojnë dhe/ose zëvendësojnë në mirëbesim përmbajtjen për të eliminuar vesin që shkakton pavlefshmërinë.

**15. Heqja dorë**

15.1 Nëse ndonjë nga Palët nuk i referohet një parashikimi të kësaj Kontrate ose nuk ushtron një të drejtë, në asnjë rast kjo sjellje nuk do të konsiderohet si dorëheqje nga ky parashikim ose nga ushtrimi i kësaj të drejte, dhe kjo sjellje nuk mund të cënojë vlefshmërinë e kësaj Kontrate. Dorëheqja nga të gjitha Palët e ushtrimit të një të drejte apo dispozite nuk do të pengojë këtë Palë të ushtrojë më vonë këtë të drejtë apo t'i referohet më vonë kësaj dispozite, në kuptim të kësaj Kontrate.

**16. Mjetet ligjore**

16.1 Të gjithë të drejtat e Palëve dhe mjetet ligjore të përcaktuara në këtë Kontratë iu shtohen të drejtave dhe mjeteve ligjore të përcaktuara dhe të lejuara nga ligji për Palët, dhe si rrjedhojë Palët do të mbrohen nga sistemet e mbrojtjes ligjore dhe kontraktore.

**UNË NOTERI, PASI VERIFIKOVA IDENTITETIN E PERSONAVE QË U PARAQITËN PARA MEJE, SI DHE ZOTËSINË E TYRE PËR TË KUPTUAR DHE VEPRUAR, LEXOJ MË ZË TË LARTE TEKSTIN E KËSAJ KONTRATE, DHE PALËT, DEKLAROJNË SE E GJEJNË TEKSTIN E MËSIPËRM NË PËRPUTHJE ME VULLNETIN E TYRE. PERSONAT E PARAQITUR PARA MEJE NËNSHKRUAN KËTË KONTRATË DUKE FIRMOSUR SI MË POSHTË, DHE UNË NOTERI E VËRTETOJ ATË NË PËRPUTHJE ME LIGJIN.**

**SHITËSI** | **BLERËSI**

Shoqeria "**Mag Utilities**" shpk
**Ortaku i vetem**

**GAZMEND METOHU**

Gazmend Metohu

**RESMI NIKA**

Resmi Nika

**NOTERI**

Regjistri i Barrëve Sigurnese

Rr. e Dibres, Qendra e Biznesit Observator
Selvia, Kati XII
TIRANE, SHQIPERI
TEL/FAX.:355 4 2420005
TEL:355 4 2420006
Email: rbs@roen-al.com

# REZULTATET E KERKIMIT

**INFORMACION I PERGJITHSHEM:**

| | |
|---|---|
| Numri i Rezultatit te kerkimit: | D-20240711161935657 |
| Data e Rezultatit te Kerkimit: | 11.07.2024 |
| Ora e Rezultatit te Kerkimit: | 16:19:35 |
| **Lloji i Kerkimit:** | **Emri i Personit Juridik** |
| **Kriteri i Kerkimit:** | **(EM) MAG UTILITIES SH.P.K.** |
| Numri i Dokumentit: | D-400-563-4184 |

**NUMRI I REZULTATEVE TE GJETURA SIPAS :**

**(EM) MAG UTILITIES SH.P.K.** **ESHTE** **3**

## *************** REGJISTRIMI -A-20190719163832137 ***************

| | |
|---|---|
| Data e Regjistrimit: | 19.07.2019 |
| Ora e Regjistrimit: | 16:38:32 |
| Kohezgjatja Regjistrimit (vite): | 11 |
| Data e Perfundimit te Regjistrimit: | 19.07.2030 |
| Numri i Dokumentit: | A-321-001-11248 |
| Referenca e Perdoruesit: | |

**BARREMARRESI (Kreditor):**

| Emri i Personit Fizik/Juridik | Adresa |
|---|---|
| (EM) RAIFFEISEN BANK SH.A.<br>(NUIS) J61911005B | RR. KAVAJES J61911005B<br>TIRANE-TIRANE<br>SHQIPERI<br>Tel: 247914<br>Fax: 224992<br>Email: INFO@BKURSIMEVE.COM.AL |

Rr. e Dibres, Qendra e Biznesit Observator
Selvia, Kati XII
TIRANE, SHQIPERI
TEL/FAX: 355 4 2420005
TEL:355 4 2420006
Email: rbs@roen-al.com

**BARREDHENESI (Debitor):**

| Emri i Personit Fizik/Juridik | Adresa |
|---|---|
| (EM) MAG UTILITIES SH.P.K.<br>(NUIS) L52430023N | RRUGA SAMI FRASHERI L52430023N<br>TIRANE-TIRANE<br>SHQIPERI<br>Tel:<br>Fax:<br>Email: |

**KOLATERAL TJETER:**

BAZUAR NE MARREVESHJEN SIGURUESE DATE 05.07.2019 ME NR REP 2224,NR KOL 382 LIDHUR PARA NOTERES DONIKA GJINI NOTERE NE DHOMEN E NOTERISE TIRANE ME PERSHKRIM KOLATERALI SI ME POSHTE:

BARREDHENESI KETU I JEP BARREMARRESIT NJE BARRE SIGURUESE ("BARRE SIGURUESE") NE:

LLOGARITE BANKARE DHE TE GJITHA TE ARKETUESHMET TE TASHME DHE TE ARDHSHME QE KREDIMARRESI/BARREDHENESI KA OSE DO TE KETE PRANE KREDIDHENESIT/BARREMARRESIT TE KREDITUARA NE LLOAGRITE PRANE BARREMARRESIT DHE NE CDO LLOGARI TJETER TE TASHME APO TE ARDHME TE CELUR APO QE DO TE CELET NEN NUMRIN E IDENTIFIKIMIT PERSONAL B89551 , SI DHE PRANE CDO BANKE TJETER TE NIVELIT TE DYTE NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE, PERFSHIRE TE GJITHA INTERESAT DHE TE DREJTAT QE AI PERFITON , QE RRJEDHIN NGA KONTRATA SI VIJON:

KONTRATA ME OBJEKT "ZGARA DHE PUSETA" DATE 12.06.2019 TE LIDHUR MIDIS "DREJTORIA E PERGJITHSHME NR. 2 E PUNETOREVE TE QYTETIT" DHE BARREDHENESIT "MAG UTILITIES" SHPK;

**PERSONI REGJISTRUES:**

| Emri i Personit Fizik/Juridik | Adresa |
|---|---|
| (EM) RAIFFEISEN BANK SH.A.<br>(NUIS) J61911005B | RR. KAVAJES<br>TIRANE<br>TIRANE-TIRANE<br>SHQIPERI<br>Tel: 247914<br>Fax: 224992<br>Email: INFO@BKURSIMEVE.COM.AL |

Rr. e Dibres, Qendra e Biznesit Observator
Selvia, Kati XII
TIRANE, SHQIPERI
TEL/FAX :355 4 2420005
TEL:355 4 2420006
Email: rbs@roen-al.com

**NENSHKRIMI I AUTORIZUAR:**

Emri i Personit Fizik/Juridik
KLELIA JOKA

## FUNDI I REGJISTRIMIT - A-20190719163832137

## *************** REGJISTRIMI -A-20190805094843677 ***************

| | |
|---|---|
| Data e Regjistrimit: | 05.08.2019 |
| Ora e Regjistrimit: | 09:48:43 |
| Kohezgjatja Regjistrimit (vite): | 11 |
| Data e Perfundimit te Regjistrimit: | 05.08.2030 |
| Numri i Dokumentit: | A-321-001-11312 |
| Referenca e Perdoruesit: | |

**BARREMARRESI (Kreditor):**

| Emri i Personit Fizik/Juridik | Adresa |
|---|---|
| (EM) RAIFFEISEN BANK SH.A.<br>(NUIS) J61911005B | RR. KAVAJES J61911005B<br>TIRANE-TIRANE<br>SHQIPERI<br>Tel: 247914<br>Fax: 224992<br>Email: INFO@BKURSIMEVE.COM.AL |

**BARREDHENESI (Debitor):**

| Emri i Personit Fizik/Juridik | Adresa |
|---|---|
| (EM) MAG UTILITIES SH.P.K.<br>(NUIS) L52430023N | RRUGA SAMI FRASHERI L52430023N<br>TIRANE-TIRANE<br>SHQIPERI<br>Tel:<br>Fax:<br>Email: |

Rr. e Dibres, Qendra e Biznesit Observator
Selvia, Kati XII
TIRANE, SHQIPERI
TEL/FAX: 355 4 2420005
TEL:355 4 2420006
Email: rbs@roen-al.com

**KOLATERAL TJETER:**

BAZUAR NE MARREVESHJEN SIGURUESE DATE 05.07.2019 ME NR REP 2224,NR KOL 382 LIDHUR PARA NOTERES DONIKA GJINI NOTERE NE DHOMEN E NOTERISE TIRANE ME PERSHKRIM KOLATERALI SI ME POSHTE:
BARREDHENESI KETU I JEP BARREMARRESIT NJE BARRE SIGURUESE ("BARRE SIGURUESE") NE:
LLOGARITE BANKARE DHE TE GJITHA TE ARKETUESHMET TE TASHME DHE TE ARDHSHME QE KREDIMARRESI/BARREDHENESI KA OSE DO TE KETE PRANE KREDIDHENESIT/BARREMARRESIT TE KREDITUARA NE LLOAGRITE PRANE BARREMARRESIT DHE NE CDO LLOGARI TJETER TE TASHME APO TE ARDHME TE CELUR APO QE DO TE CELET NEN NUMRIN E IDENTIFIKIMIT PERSONAL B89551 , SI DHE PRANE CDO BANKE TJETER TE NIVELIT TE DYTE NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE, PERFSHIRE TE GJITHA INTERESAT DHE TE DREJTAT QE AI PERFITON , QE RRJEDHIN NGA KONTRATA SI VIJON:KONTRATA ME OBJEKT "ZGARA DHE PUSETA" DATE 12.06.2019 TE LIDHUR MIDIS "DREJTORIA E PERGJITHSHME NR. 2 E PUNETOREVE TE QYTETIT" DHE BARREDHENESIT "MAG UTILITIES" SHPK;

**PERSONI REGJISTRUES:**

| Emri i Personit Fizik/Juridik | Adresa |
|---|---|
| (EM) RAIFFEISEN BANK SH.A.<br>(NUIS) J61911005B | RR. KAVAJES<br>TIRANE<br>TIRANE-TIRANE<br>SHQIPERI<br>Tel: 247914<br>Fax: 224992<br>Email: INFO@BKURSIMEVE.COM.AL |

**NENSHKRIMI I AUTORIZUAR:**

Emri i Personit Fizik/Juridik
KLELIA JOKA

**FUNDI I REGJISTRIMIT - A-20190805094843677**

Rr. e Dibres, Qendra e Biznesit Observator
Selvia, Kati XII
TIRANE, SHQIPERI
TEL/FAX:355 4 2420005
TEL:355 4 2420006
Email: rbs@roen-al.com

RBS
Regjistri i Barrëve Siguruese

## *************** REGJISTRIMI -A-20240206143904453 ***************

| | |
|---|---|
| Data e Regjistrimit: | 06.02.2024 |
| Ora e Regjistrimit: | 14:39:04 |
| Kohezgjatja Regjistrimit (vite): | 10 |
| Data e Perfundimit te Regjistrimit: | 06.02.2034 |
| Numri i Dokumentit: | A-321-001-15045 |
| Referenca e Perdoruesit: | |

**BARREMARRESI (Kreditor):**

| Emri i Personit Fizik/Juridik | Adresa |
|---|---|
| (EM) RAIFFEISEN BANK SH.A.<br>(NUIS) J61911005B | RR. KAVAJES J61911005B<br>TIRANE-TIRANE<br>SHQIPERI<br>Tel: 247914<br>Fax: 224992<br>Email: INFO@BKURSIMEVE.COM.AL |

**BARREDHENESI (Debitor):**

| Emri i Personit Fizik/Juridik | Adresa |
|---|---|
| (EM) MAG UTILITIES SH.P.K.<br>(NUIS) L52430023N | TIRANE<br>TIRANE-TIRANE<br>SHQIPERI<br>Tel:<br>Fax:<br>Email: |

**KOLATERAL TJETER:**

BAZUAR NE MARREVESHJEN SIGURUESE DATE 30.01.2024 ME NR REP 758,NR KOL 83
LIDHUR PARA NOTER DONIKA GJINI NOTER NE DHOMEN E NOTERISE TIRANE
ME PERSHKRIM KOLATERALI SI ME POSHTE:
BARREDHENESI KETU I JEP BARREMARRESIT NJE BARRE SIGURUESE ("BARRE SIGURUESE") NE:
LLOGARITE BANKARE DHE CASH QE KREDIMARRËSI/BARREDHENESI SHOQERIA "MAG UTILITIES" SHPK KA OSE DO TE KETE PRANE KREDIDHENESIT/BARREMARRESIT NEN NUMRIN E IDENTIFIKIMIT PERSONAL SI ME POSHTE DHE NE CFAREDO NUMRI TJETER IDENTIFIKIMI TE PERCAKTUAR NGA BANKA, PERFSHIRE TE GJITHA INTERESAT DHE TE DREJTAT QE AI PERFITON:
SHOQERIA "MAG UTILITIES" SHPK ME NUMER IDENTIFIKIMI PERSONAL B89551

Rr. e Dibres, Qendra e Biznesit Observator
Selvia, Kati XII
TIRANE, SHQIPERI
TEL/FAX:355 4 2420005
TEL:355 4 2420006
Email: rbs@roen-al.com

**PERSONI REGJISTRUES:**

| Emri i Personit Fizik/Juridik | Adresa |
| --- | --- |
| (EM) RAIFFEISEN BANK SH.A.<br>(NUIS) J61911005B | RR. KAVAJES<br>TIRANE<br>TIRANE-TIRANE<br>SHQIPERI<br>Tel: 247914<br>Fax: 224992<br>Email: INFO@BKURSIMEVE.COM.AL |

**NENSHKRIMI I AUTORIZUAR:**

Emri i Personit Fizik/Juridik
LULJETA MERTIRAJ

**FUNDI I REGJISTRIMIT - A-20240206143904453**

Fundi i Rezultatit te Kerkimit

Fundi i Dokumentit

REGJISTRI I BARREVE SIGURUESE
R.B.S.
TIRANE - ALBANIA

**SUBJEKTI KERKUES:**

Emertimi
NIKOLETA PALUSH GJORDENI P.F.

Erisa Hysaj

**TE DHENAT E PERDORUESIT:**

Emri dhe Mbiemri
ERISA HYSAJ

Rr. e Dibres, Qendra e Biznesit Observator
Selvia, Kati XII
TIRANE, SHQIPERI
TEL/FAX.:355 4 2420005
TEL:355 4 2420006
Email: rbs@roen-al.com